

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"AL - GO 2023" SHPK**

Sot, më datë 28/09/2023, u paraqit personalisht:

- Z. Agron Malaj, i datëlindjes 05/11/1978, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Vlorë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr BB3884528 dhe Nr. Personal H81105055F.

I cili përpiloj këte akt themelimi të shoqërisë tregtare "AL - GO 2023" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "AL - GO 2023" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "AL - GO 2023" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "AL - GO 2023" SH.P.K dhe me emrin tregtar **AL - GO 2023**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Ndërtimi, restaurim dhe mirëmbajtja e ndërtesave civile të larta dhe industriale. Ndertimin ne pergjithesi dhe ne vecanti. Ndertim i te gjitha llojeve, ndertesave rezidenciale dhe jorezidenciale. Ndertesa qytetare dhe vepra te lidhura e plotesuese. Konstruksione te ndryshme brenda fushes se ndertimit. Ndertimi dhe mirembajta e rrugeve. Punime rrugore speciale, shtrime special, stabilizim terrenesh, shenja te qarkullimit dhe te sigurise. Punime hidraulike special, gazsjelles, vajguer sjelles, impiante pompimi, impiante te ujit te pijshem, impiante te depurimit, shpime dhe puse, izolime pershkueshmerie dhe izolime special te pershkueshmerise. Punime veprash speciale te ndryshme, rilevime topografike

speciale, eksplorime te nentokes me mjete speciale, themele special. Ndertim, arredim, dizenzim te dhomave te hotelerive.

- Marrja dhe dhënia me qira e strukturave të ndryshme akomoduese turistike. Aktivitete ne fushen e hoteleri-turizmit. Dhënie me qira afatshkurter te ambienteve te mobiluara per turistet nepermjet platformave ne internet. Ofrimin per turistet te akomodimit dhe ushqimit ne te gjitha vaktet. Ofrimi i sherbimeve te guides turistike.
- Aktivite në fushën e agro-turizmit

NENI 5
Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Vlorë, në adresën: Zyrë Katë II me Nr. Pas. 26/97-N153, Z.K. 8603,
Rr. Lef Sallata, Vlorë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njeqind mijë leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (njeqind mijë leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku themelues.

NENI 7

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare "AL - GO 2023" SH.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	Agron Malaj
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesemarrja ne Shoqeri :	100,00 %
Lloji i kontributit:	Ne para
Vlera e kontributit	100,000 (njeqind mijë) leke

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e rregjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.
Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jetë :

- **Z. Agron Malaj, i datëlindjes 05/11/1978, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Vlorë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr BB3884528 dhe Nr. Personal H81105055F.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartoher në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njobës i gjuhes shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Agron Malaj

Faqe 3 nga 3